



Pranuar / Dorezuar Priljena/Prodato Received/Deliverty	09-06-2023	3	viti god year
Organ /Njësia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Itr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIKMSHJK	4661/2023		117



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 629/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari - kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi - anëtarë, si dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A.Nr.629/2023, të datës 12.04.2023, të ankuesit

kundër organit të punësimit Agjencia Kosovare e Privatizimit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 09.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa me numër A.nr.629/2023, e datës 12.04.2023, e parashtruar nga ankuesi
- II. ~~Anulohen~~ Vendimi me numër DM-113/2023 i datës 05.04.2023, si dhe Vendimi i datës me numër DM 112/2023 i datës 05.04.2023 i Drejtoreshës së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
- III. **Obligohet** Njësia e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të rishqyrtoj aplikacionin me numër reference RN00010969 të datës 21.03.2023 dhe aplikacionin me numër reference RN00010838 të datës 21.03.2023 tw ankuesit , duke marrë parasysh të gjeturat sipas këtij vendimi.
- IV. **Obligohet** Drejtori i Përgjithshëm në Agjencinë Kosovare për Privatizim, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi siç përcaktohet në pikën III të dispozitivit.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim

A r s y e t i m

Agjencia Kosovare e Privatizimit duke u bazuar ne Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 40 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 01/2022 Për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, përmes njoftimit të datës 13.02.2023, ka shpallur konkursin për dy pozita „Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm” me numër Reference RN00010969 dhe konkursin për pozitën “Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm me numër te referencës RN00010838 me afat aplikimi nga data 15.03.2023 deri me datën 22.03.2023”. Ne te dyja konkurset dhe për dy pozitat ka aplikuar edhe ankuesi.

Sipas Vendimit me numër DM-106/2023 të datës 31.03.2023 dhe Vendimit me numër DM-105/2023 të datës 31.03.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore pranë Agjencisë Kosovare së Privatizimit ankuesit në të dy pozitat i është refuzuar aplikacioni për arsye se i njëjti nuk i ka plotësuar kriteret e parapara për pozitën “Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm” ne Agjencinë Kosovare së Privatizimit.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin me numër DM-106/2023 te datës 31.03.2023 dhe Vendimit me numër DM-105/2023 të datës 31.03.2023, me datën 03.04.2023 ka parashtruar ankesë përmes emailit zyrtar pranë Njesisë se Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare së Privatizimit. Ndërsa kjo e fundit me datën 05.04.2023 përmes vendimit me numër DM-113/2023 dhe vendimit te datës 05.04.2023 me numër DM-112/2023 e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar me arsyetim se ankuesi nuk ka arritur të dëshmoj se nuk ka masë disiplinore në fuqi në momentin e aplikimit n konkursin në fjalë.

Ankuesi me datë 12.04.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër vendimit DM-112/2023 dhe vendimit me numër DM-113/2023 me pretendim ankimore se Agjencia Kosovare e Privatizimit me rastin e marrjes së Vendimeve në fjalë ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe Aplikim të gabuar te Ligjit për Zyrtar Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me datë 20.04.2023, ka dërguar përgjigje në ankesë me numër protokollit 8012/2022 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit, ndërsa kjo e fundit me datë 16.05.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë tek Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 3469/2023 të datës 12.04.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër të referencës R00010969 të datës 13.02.2023 për pozitën e punës “Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm”; Konkursin me numër të referencës RN00010838 të datës 13.02.2023 për pozitën e punës “Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm”; Vendimin me numër DM 106/2023 të datës 31.03.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burimeve Njerëzorë; Vendimin me numër DM 105/2023 të datës 31.03.2023;

Vendimin me numër DM-113/2023 të datës 05.04.2023 të Drejtorit të Burimeve Njerëzore; Vendimin me numër DM-112/2023 të datës 05.04.2023 të Drejtorit të Burimeve Njerëzore; Emailin e datës 07.04.2023 të M. Arifi drejtuar A.Limani; Emailin e datës 07.04.2023 të A.Limani drejtuar Emailin e datës 07.04.2023 të M.Arifi drejtuar A.Limani; Emailin e datës 06.04.2023 të Burimeve Njerëzore drejtuar M.Arifi; Emailin e datës 03.04.2023 të M.Arifi drejtuar L.Xharra; Emailin e datës M.Gacaferri drejtuar Vendimin me numër 1503 të datës 26.05.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 3723/2023 të datës 20.04.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 16.05.2023; Vendimin me Nr.Ref.BD-174-3; Emailin e datës 15.02.2023 të L.Xharra drejtuar PAK All; Listën e Aplikantëve me numër të referencës RN00010969; Listën e aplikantëve me numër të referencës RN00010838; Aplikacionin e datës 21.03.2023 të ankuesit për konkursin me numër të referencës RN00010969 ; Aplikacionin e datës 21.03.2023 të ankuesit për konkursin me numër të referencës RN00010838; Diplomën me numër 28/10 të datës 16.11.2010; Diplomën me numër 57 të datës 12.12.2007; Licencën me numër 1/2021 të datës 07.06.2021; Certifikatën e lëshuar nga Ministria e Administratës Publike lidhur me përfundimin e trajnimit Etika dhe Antikorrupsioni në Administratën Publike -Prishtinë 2017; Vërtetimin lidhur me përfundimin me sukses të provimeve ne SCAAK; Certifikatën e lëshuar nga UNMIK; Diplomën me numër NIPT/K62122040A lidhur me përfundimin e kursit 3-mujor Para universitar për marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci në periudhën 1 mars-25 maj 2007; Certifikatën e datës 23-24.11.2004; Certifikatën e muajit korrik-2004; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit fundamental Managements Skills të mbajtur me datën 15-16 Prill 2004; Certifikatën e datës 16.05.2020; Certifikatën e datës 12.04.2002; Certifikatën e datës 20.03.2002; Certifikatën e datës 26.04.2001; Certifikatën e datës 08.10.1999; Certifikatën lidhur me përfundimin me sukses të trajnimit në Institutin e teknologjisë në Hunter; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit In the summer and ëinter of 199 and 200 ARC Internacional provididid emergency shelter assistance to hundreds of families in the area of Gjilan; Vërtetimin e datës 21.03.2023 për punësimin e ankuesit; Shkresën e datës 12.06.2008; shkresën e datës 07.10.2005; Dokumentin e identifikimit të ankuesit; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 14.02.2023; Formularin për përcaktimin e objektivave të punës të datës 24.01.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve të punës të nëpunësve civil dhe të nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional të datës 24.01.2022; Planin individual të datës 24.01.2022; Letër motivuese të ankuesit; Certifikatën mbi dënimin penale të datës 21.03.2023; Vendimin me numër të protokollit 1503 të datës 26.05.2022; Vendimin me numër A.nr.539/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër A.nr.1152/2022 të datës 26.01.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin nën shenjën DM 103/2023 të datës 31.03.2023; Listën me numër të referencës RN00010969 të aplikantëve; Njoftimin nën shenjën DM102/2023 të datës 31.03.2023; Listën me numër të referencës RN00010383 të aplikantëve; Emailin e datës 03.04.2023 të drejtuar L.Xharra; Emailin e datës 31.03.2023 të M.Gacaferri drejtuar Vendimin nën shenjën DM112/2023; Vendimin nën shenjën DM 113/2023 të datës 05.04.2023; Njoftimin nën shenjën DM 126/2023 të datës 18.04.2023; Aplikacionin e kandidatit Ramë Zegragja; Diplomën me numër 2545 të datës 02.10.2018; Certifikatën e datës 10.07.2004; Certifikatën e datës 15.01.2005; Certifikatë e datës 25.06.2005; Certifikatën e datës 04.02.2006; Certifikatën e datës 08.09.2006; Shkresën e datës 10.02.2009; Kontratën e punës të datës 23.12.2009; Kontratën e punës të datës 31.12.2010; Emailin e datës 14.05.2010; Kontratën e punësimit të datës 04.02.2011; Kontratën e punës të datës 28.12.2011; Deklaratën e datës 28.12.2011; Akt emërimit të datës 24.12.2012; Akt emërimit 27.04.2015; Akt emërimit të datës 28./12.2022; Përshkrimin e detyrave të punës; Shkresën e datës 19.02.2016; Letër

rekomandimin e datës 16.02.2016; Dokumentin e identifikimit të R.Zagragaj; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 22.02.2023; Emalin e datës 15.02.2023 të L.Xharra drejtuar R.Zagraxha; Formularin e vlerësimeve në punës të datës 31.01.2022; Letër rekomandimin e datës 21.03.2023; Vërtetimin mbi punësimin të datës 21.03.2023; Vërtetimin e datës 07.03.2023; Vërtetimin e datës 07.03.2023; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 27.22.2023; Formularin e rezultateve në punë të datës 27.01.2021; Aplikacionin e kandidates V.Dibra; Diplomën me numër 2762 të datës 25.05.2011; Certifikatën (pa datë dhe numër) të lëshuar nga SCAAK; Certifikatën e datës 07.02.2005; Certifikatën (pa datë dhe numër) lidhur me përfundimin e trajnimit "Internacional Public Sector Accounting Standards; Certifikatën e datës 25.05.2007; Certifikatën e datës 26-28-06.2002; Certifikatën lidhur me përfundimin me sukses të trajnimit Menaxhim i Përgjithshme Publike për periudhën shkurt-2004 -janar 2005; Certifikatën e datës 03-06-2011; Certifikatën e datës 30.06.2003; Certifikatën e datës 21.05.2007; Certifikatën e datës 20.05.2003; Vërtetimin mbi mardhnin e punës të datës (pa datë dhe numër); Shkresën e datës 09.06.2008; Vërtetimin me numër 1028 të datës 22.03.2023 mbi punësim; Vërtetimin me numër 103/2015 të datës 12.05.2015; Vërtetimin me numër të protokollit 1028 të datës 22.03.2023; shkresën e datës 03.09.2003; Shkresën e datës 12.03.2011; Dokumentin e identifikimit të kandidates V.Dibra; Formularin për Vlerësimin e detyrave në punë; Formularin për vlerësimin e detyrave në punë (pa data dhe numër); Formularin për vlerësimin e detyrave ne punë të datës 29.01.2021; Vërtetimin për punësim me numër të protokollit 1028 të datës 22.03.2023; Letrën motivuese të datës 22.03.2023; Vërtetimin mbi punësimin për kandidaten V.Dibra të datës 22.03.2023; Formularin për vlerësimin e detyrave në pune pa (datë dhe numër); Formularin për vlerësimin e detyrave në punë të datës 29.01.2021; Diplomën me numër 2762 të datës 25.05.2011; Certifikatën lidhur me përfundimin e SCAAK; Certifikatën e datës 07.02.2005; Vërtetimin mbi punësim të datës 18.02.2016; Vërtetimin mbi marrëdhënien e punës (pa date dhe numër) Vërtetimin me numër 103/2015 të datës 12.05.2015; Shkresën e datës 12.03.2011; Referencën e datës 10.07.2001; shkresën e datës 03.07.2003; Shkresën e datës 14.09.2007; shkresën e datës 09.06.2008; Betimin e datës 21.02.2011; Certifikatën (pa datë dhe numër); Certifikatën (pa datë dhe numër); Certifikatën (pa datë dhe numër); Certifikatën lidhur me përfundimin me sukses të trajnimit Menaxhimi i përgjithshëm Publik; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin "Menaxhimi dhe Ekzekutimi i Shpenzimeve Publike nga Organizatat Buxhetore të Kosovës"; Certifikatën e datës 08.07.2003; Certifikatën pa (datë dhe numër); Certifikatën e datës 23.05.2003; Certifikatën e datës 08.01.2002; Certifikatën e datës 23.04.2002; Certifikatën e datës 09.01.2004; Certifikatën e datës 29.06.2004; Certifikatën (pa datë dhe numër); Certifikatën (pa datë dhe numër); Certifikatën e datës 14.07.2003; Certifikatën e datës 20.05.2023; Dokumentin e identifikimit; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 15.03.2023; Njoftimin e datës 18.04.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare për Privatizim;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e bazuar sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, sipas shkresave të lëndës ka gjetur se Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me datë 23.12.2022 ka nxjerrë Vendimin me Nr.ref BD-174-3 për inicimin e procedurës së rekrutimit për pozitën „Zëvendës drejtor Menaxhues për Funksiione Operative dhe për pozitën „Zëvendës drejtor Menaxhues për Funksiione të Përgjithshme në Agjencinë Kosovare të Privatizimit përmes konkursit publik.

Agjencia Kosovare e Privatizimit duke u bazuar ne Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 40 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 01/2022 Për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, përmes njoftimit të datës 13.02.2023, ka shpallur konkursin për dy pozita „Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm“ me numër Reference RN00010969 dhe konkursin për pozitën “Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm me numër te referencës RN00010838 me afat aplikimi nga data 15.03.2023 deri me datën 22.03.2023”.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se për të dy pozitat “ Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm” në Agjencinë Kosovare për Privatizim si kërkesa të përgjithshme për pranim janë përcaktuar: *Të jete shtetas i Republikës se Kosovës, të ketë zotësi te plotë për te vepruar, te zotëroj njëren nga gjuhet zyrtare, ne pajtim me Ligjin për gjuhet, Te jete i afte ne pikëpamje shëndetësore për te kryer detyrat përkatëse, Te mos jete i dënuar me vendimin e formës se prere për kryerjen e një vepre penale me dashje, te mos ketë ne fuqi një mase disiplinore për largim nga një pozite e zyrtarit publik, te pushuar sipas Ligjit nr.06/L-114 për zyrtar publik. Ndërsa si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar:*

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 4 vite të studimeve,*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku tetë(8) vite përvojë pune profesionale duke përfshirë së paku pesë(5) vite përvojë pune në pozita drejtuese.*

Ndërsa dokumentacionet që duhet të paraqiten për aplikim për te dy pozitat janë përcaktuar si në vijim: *Aplikacioni i cili plotësohet në mënyre online me rastin aplikimit , Kopjen e diplomave mbi kualifikimin arsimor, nostrifikimin për diplomat e marra jashtë vendit , Dëshmi për përvojën e punës, Letër motivimin, Kopjen e vlerësimeve te punës për dy vitet e fundit, Dëshmi nga institucionet ku punon që nuk ka masë disiplinore, Certifikatën nga Gjykata qe nuk është i dënuar me vendimin e formës se prerës për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo me te vjetër se gjashte (6) muaj nga data e lëshimit si dhe çdo dokument qe provon plotësimin e kushteve për aplikim te përcaktuar ne shpalljen e konkurrimit dhe te deklaruar ne aplikacion.*

Sipas Vendimit me numër DM-106/2023 të datës 31.03.2023 dhe Vendimit me numër DM-105/2023 të datës 31.03.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore pranë Agjencisë Kosovare së Privatizimit ankuesit në të dy pozitat i është refuzuar aplikacioni për arsye se i njëjti nuk i ka plotësuar kriteret e parapara për pozitën “Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm” ne Agjencinë Kosovare së Privatizimit dhe poashtu Njësia e Burimeve Njerëzore pranë Agjencisë Kosovare së Privatizimit me datën 05.04.2023 përmes vendimit me numër DM-113/2023 dhe vendimit te me numër DM-112/2023 e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar me arsyetim se ankuesi nuk ka arritur të dëshmoj se nuk ka masë disiplinore në fuqi në momentin e aplikimit n konkursin në fjalë.

Ankuesi me datë 12.04.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër vendimit DM-112/2023 dhe vendimit me numër DM-113/2023 me pretendim ankimore se Agjencia Kosovare e Privatizimit me rastin e marrjes së Vendimeve në fjalë ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të Ligjit për Zyrtar Publik. Ankuesi në ankesë pretendon se masa disiplinore e cila paraqet pengesë për aplikim në konkurrim është e paraparë shprehimisht me paragrafin 1.3 të nenit 47 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik i cili në ankesën e parashtruar në këshill ka **citur;** „Ndalim i

ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet ndërsa në rastin konkret ankuesit i është shqiptuar masa e parapare me paragrafin 1.2 të nenit 47 të Ligjit në fjalë.

Kolegji i Këshillit, ka gjetur se Agjencia Kosovare për Privatizim me rastin e refuzimit të aplikacionit me numër RN00010969 dhe aplikacionit me numër RN00010838 ka vepruar në kundërshtim, nenin 8 të Ligjit Nr.06/L114 për Zyrtar Publik, sepse nuk ka marr për bazë **Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë** të cilat përcaktojnë se 1. *Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë: 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar; 1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore të kryer detyrat përkatëse; 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.* Andaj kolegji i këshillat pas analizimit të shkresave të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit nuk ka gjetur asnjë dëshmi se ankuesi ka mase disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publikë, të pushuar sipas këtij ligji, ndërsa sa i përket masës disiplinore të datës 26.05.2022 e cila është në dosjen e ankuesit nuk është parapare në asnjë dispozitë ligjore që ankuesin e penalizon që të mos jetë kandidat në konkursin me numër reference RN00010969 dhe konkursin me numër reference RN00010838 për pozitën e punës Zëvendës Drejtor në Agjencinë Kosovare për Privatizim, ngase ankuesi nuk ka masë disiplinore për largim nga pozita e zyrtarit publik apo nuk ka masë disiplinore në fuqi për ndalim të ngritjes në detyrë, ndërsa dispozitat e lartëcekura nuk kërkojnë që për pozitën e kategorisë së lartë drejtuese kandidatët nuk duhet të kenë asnjë masë disiplinore në fuqi.

Bazuar në dispozitat e cekura si më lartë dhe bazuar në gjendje faktike dhe bazën juridike të vërtetuar si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit është e obliguar që të rishqyrtoj aplikacionin e ankuesit në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi dhe të njoftoj ankuesin në pajtim me legjislacionin përkatës.

Po ashtu Kolegji i Këshillit, ka analizuar nenin 8 të Rregullore (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues i cili ka përcaktuar se 5. *Kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kushtet për aplikim nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Njoftimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim arsyetohet duke përfshirë të gjitha kriteret dhe/ose dëshmitë e papërmblushura dhe u dërgohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve.* 6. *Brenda pesë (5) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, në pajtim me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin - kërkesë me shkrim për sqarime shtesë ose të paraqiten tek Njësia Përgjegjëse për t'u njohur me arsyet e detajuara për mos kualifikim për konkurrim të mëtejshëm.* 7. *Njësia Përgjegjëse, brenda afatit prej pesë (5) ditëve kalendarike duhet të përgjigjet me shkrim në kërkesën e kandidatit si në paragrafin 6 të këtij neni, duke dhënë arsyet e detajuara për mos kualifikim për konkurrim të mëtejshëm.* 8. *Kandidati i pa kënaqur me përgjigjen me shkrim si në paragrafin 7 të këtij neni, ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, brenda afatit prej tetë (8) dite kalendarike pas pranimit të përgjigjes.* Si rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit, konstaton se në bazë të kësaj dispozite nuk është përcaktuar që Njësia e Burimeve Njerëzore në rastin e shqyrtimit të aplikacioneve të kandidatëve duhet të nxjerr vendim për refuzim të aplikacionit po ashtu nuk është përcaktuar që me rastin e shqyrtimit të kërkesës së palëve që nuk përfshihen në listën e verifikimit paraprak duhet të nxjerr vendim, ndërsa në rastin konkret të ankuesit në të dyja rastet është nxjerr akt administrativ (vendim).

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A nr. 629/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri



Procesmbajtëse

Malsore GASHI - BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit*
- *Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë Kosovare të Privatizimit*
- *Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së;*